



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK1307/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI27/18

Parashtrues

Sinan Thaqi dhe Hasan Thaqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 76/2017, të 3 majit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sinan Thaqi dhe Hasan Thaqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës) nga fshati Mirushë, komuna e Malishevës, të përfaqësuar nga Mentor Neziri, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 76/2017, të 3 majit 2017 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 4323/2015, të 14 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, C. nr. 82/2009, të 28 shtatorit 2015.
3. Vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 29 qershor 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura të gjykatave të rregullta. Parashtruesit e kërkesës nuk i referohen ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, por nga përmbajtja e kërkesës, rezulton se ata pretendojnë cenim të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 23 shkurt 2018, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 26 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 4 maj 2018, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta plotësimin e kërkesës si dhe dorëzimin e dëshmisë (fletëkthesës), që tregon datën e pranimit të vendimit të kontestuar. Të njëjtën datë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë.
10. Më 18 maj 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë dorëzoi dëshminë (fletëkthesën), që provon se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 29 qershor 2017.

11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
13. Më 19 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu dhe Radomir Laban.
14. Më 22 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 23 qershor 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në ish-Gjykatën Komunale në Malishevë kundër palëve të treta lidhur me vërtetimin e të drejtës pronësore në paluajtshmëri, në bazë të shitblerjes.
16. Më 28 shtator 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë (Aktgjykimi C. nr. 82/2009) kishte refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për vërtetim të së drejtës pronësore, në bazë të shitblerjes, të disa ngastrave kadastrale që gjenden në Zonën Kadastrale në Malishevë. Gjykata Themelore arsyetoi se parashtruesit e kërkesës nuk kishin provuar se janë pronarë të ngastrave të kontestuara sepse nuk kishte kontratë të shitblerjes me shkrim të vërtetuar nga organi kompetent, dhe veç kësaj, pala kundërshtarë gjithnjë kishte kundërshtuar ekzistencën e ndonjë kontrate të shitblerjes për ngastrat e kontestuara.
17. Ndërkohë, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit po ashtu propozuan që aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet, kërkesëpadija e palës kundërshtarë të refuzohet e pabazuar, ose aktgjykimi i kontestuar të prishet dhe lënda të kthehet për rivendosje. Parashtruesit e kërkesës në thelb pretenduan se në bazë të parashkrimit fitues (posedim i një objekti me ndërgjegje për një kohë të caktuar me ligj), ata ishin pronarë të ndërgjegjshëm të ngastrave të kontestuara.
18. Më 14 shkurt 2017, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. nr. 4323/2015), refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit arsyetoi se kontrata verbale e shitblerjes nuk plotëson asnjë kusht ligjor që do ta vërtetonte vlefshmërinë e saj. Veç kësaj, parashtruesit e kërkesës nuk kishin ofruar asnjë provë për posedim të ndërgjegjshëm të ngastrave të kontestuara për t'i konsideruar ata pronarë në bazë të "parashkrimit fitues".

19. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për revizion kundër vendimeve të lartpërmendura në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit po ashtu propozuan që vendimet e kontestuara të anulohen dhe lënda të kthehet për rigjykim dhe të vërtetohet e drejta e tyre pronësore ndaj ngastrave kadastrale të kontestuara.
20. Më 3 maj 2017, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 76/2017) e hodhi të palejuar kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët. Gjykata Supreme arsyetoi se kërkesa për revizion ishte e palejuar sepse vlera e objektit të kontestit nuk kalonte shumën prej 3,000 € të paraparë me nenin 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Veç kësaj, parashtruesit e kërkesës nuk kishin kërkuar deri në përfundimin e seancës përgatitore të mbajtur në Gjykatën Themelore ndryshimin e vlerës së objektit të kontestit, siç parashikohet me nenin 36 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e gjykatave të zakonshme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
22. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë aktgjykim: *“... me të cilin do të aprovohet kërkesëpadia e paditësve si e bazuar dhe e pranueshme, dhe aktgjykimi dhe aktvendimi i atakuar me këtë kërkesë do të konsiderohen si vendime të cilat kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në dëm të parashtruesve të kërkesës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që parasheh:

Neni 49

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

26. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit”.

27. Gjykata vëren se pretendimet qendrore të parashtruesve të kërkesës sillen rreth së drejtës së tyre për proces të rregullt gjyqësor dhe mbrojtje të pronës, për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta *“kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në dëm të parashtruesve të kërkesës”.*
28. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat procedurale para se pretendimet e tyre për proces të rregullt gjyqësor dhe mbrojtje të pronës të shqyrtohen nga kjo Gjykatë.
29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar më 23 shkurt 2018, ndërsa aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 29 qershor 2017. Nga kjo rezulton se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë pas afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
30. Nga sa u tha më sipër, Gjykata vëren se nuk mund t’i shqyrtojë pretendimet për proces të rregullt gjyqësor dhe mbrojtje të pronës të ngritura nga parashtruesit e kërkesës, për shkak të mospërmbushjes së afatit 4 (katër) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
31. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike duke siguruar, se rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (Shih rastin *O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, Aktvendimi i GJEDNJ-së i 25 gushtit 2005, dhe *mutatis mutandis*, shih: rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, parashtrues: *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).
32. Rregullat procedurale dhe afatet kohore për ankesa janë të dizajnuara për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe, në veçanti, sigurinë ligjore. Palët ndërgjyqëse normalisht duhet të presin që këto rregulla të zbatohen. (Shih, për shembull, rasti *Belesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, GJEDNJ,

kërkesa nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 60 dhe referencat e përmendura aty).

33. Përveç kësaj, Gjykata vëren se është detyrë e parashtruesve të kërkesës ose përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me *'kujdesin e duhur'* për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të drejtave dhe lirive themelore të dorëzohen brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe të përcaktuar më tej me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës (Shih: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti KIO7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 52 dhe referencat e cituara aty dhe shih *mutadis mutandis Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [DHM], ankesa nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267; po ashtu shih *Ölmez kundër Turqisë*, Aktvendim).
34. Bazuar në vlerësimet e mësipërme, kërkesa, në baza kushtetuese, është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selyete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi